




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



A.nr.282/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani- anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës me numër A.nr.282/2026, të datës 12.03.2026, të parashtruar nga ankuesi I.GJ nga Zveçani, kundër organit të punësimit: Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “*Masë disiplinore*”, në pajtim në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 20.05.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.282/2026, e datës 12.03.2026, e parashtruar nga ankuesi I.GJ.

II. Anullohet Vendimi Nr. 261/2026, i datës 04.02.2026, i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

III. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, që të bëjnë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimin, duke ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për kthimin e ankuesit në pozitën e punës sipas akt emërimit me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës dhe kompensimin e pagave nga dita e largimit nga shërbimi civil deri në zbatimin e këtij vendimi, duke hequr edhe masën disiplinore nga dosja personale e ankuesit.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesi I.GJ(në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), përmes postës më datë 09.03.2026 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është pranuar më datë 12.03.2026 dhe është regjistruar nën shenjën A.nr.282/2026, kundër Vendimit me Nr. 261/2026, të datës 04.02.2026, të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 18.03.2026 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa kjo e fundit, më datë 10.04.2026 ka përcjellë përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës në çështjen përkatëse ankimore.

Kryesuesi i Këshillit, me datë 22.04.2026 ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2026 dhe numër protokolli:2056/2026, përmes të cilit ankesës së ankuesit nën shenjën A.nr.282/2026 të datës 12.03.2026 ia ka vazhduara afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë të tjera, ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 1282/2026, të datës 12.03.2026, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin e parashtrimit të ankesës të datës 12.03.2026; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 18.03.2026; Vendim me numër Nr.261/2026, i datës 04.02.2026; Përgjigjen në ankesë të datës 10.04.2026, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura nga organi i punësimit; Akt emërimit e ankuesit I.GJ të datës 29.12.2015; Vendimin për transferim të përkohshëm të nëpunësit civil me numër Nr.2388/2025, të datës 31.12.2025; Përshkrimi i detyrave të punës; Diplomë me numër Nr.103/11, e datës 27.07.2011; Akt emërimi i G.E me numër protokolli Nr.570/1, i datës 15.07.2020; Vendim për themelimin e komisionit me numër protokolli Nr.104/1, i datës 19.01.2026; Diplomë me numër Nr.552, e datës 26.12.2011; Akt emërimi i B.K i datës 22.08.2013; Certifikatë e datës 13.01.2022; Ndryshimi i aktit të emërimit i D.G me numër protokolli Nr.369/1, i datës 26.05.2014; E-mail i datës 26.01.2026; Akt emërimi i D.L i datës 14.05.2013; Vendimin VK/2026 e Kryesuesit të Këshillit të datës 22.04.2026.

Kolegji i Këshillit pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e bashkangjitura të lëndës të parashtruara në palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e bazuar **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankuesi sipas Akt emërimit të datës 29.12.2015, është i punësuar në pozitën e punës “Administrator teknik për kontrollin e mirëmbajtjes” në kuadër të Departamentit për Standarde të Politikave të Inxhinieringut dhe Menaxhimit të Ndërtësive Qeveritare në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ndërsa i njëjti sipas Vendimit me Nr. 2388/2025 të datës 31.12.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, është transferuar në pozitën Asistent Administrativ në Qendrën për Regjistrimin e Automjeteve në Skenderaj, Drejtorati për Regjistrimin e Automjeteve, Agjencia e Regjistrimit Civil/MPB.

Për shkak të mos paraqitjes në vendin e punës në të cilin ishte transferuar si rezultat i Vendimit me Nr. 2388/2025 të datës 31.12.2025, ndaj ankuesit është iniciuar procedurë disiplinore më datë 23.01.2026, pranë Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme për shkelje të rënda disiplinore, tutje Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme, më datë 04.02.2026, ka nxjerrë Vendimin 261/2026, me të cilin ankuesin e ka bërë përgjegjës për shkelje të rënda disiplinore të përcaktuar me nenin 56 paragrafi 4 nën paragrafi 4.1 4.4 dhe 4.10 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, duke i shqiptuar masën disiplinore *Largim nga shërbimi civil*.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. 261/2026, të datës 04.02.2026, të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, pretendon se parashtrimi i ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pezullon efektet e zbatimit të vendimit për transferim, gjegjësisht Vendimit me Nr. 2388/2025 të datës 31.12.2025, po ashtu ankuesi pretendon se vendimi i kontestuar nuk ka arsyetim dhe është në kundërshtim me nenin 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe ligjin material, sikurse i njëjti e konteston edhe përbërjen e komisionit.

Ministria e Punëve të Brendshme, përmes përgjigjes në ankesë të datës 10.04.2026, kundërshton pretendimet ankimore të ankuesit, duke theksuar se vendimi për transferim, nuk është anuluar, nuk është shfuqizuar e as nuk është pezulluar nga organi kompetent e për rrjedhojë, ai ka qenë akt administrativ i vlefshëm dhe i ekzekutueshëm, i cili ka prodhuar efekte juridike dhe ka qenë detyrues për zbatim, prandaj, ankuesi ka qenë i obliguar të paraqitet në vendin e ri të punës deri në një vendimmarrje përfundimtare. Komisioni Disiplinor është themeluar dhe ka funksionuar në përputhje të plotë me nenin 10 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2024, sipas të cilit komisioni përbëhet nga tre (3) anëtarë, duke përfshirë një përfaqësues të NJMBNJ-së dhe së paku një jurist. Përbërja e komisionit ka qenë në përputhje me këto kërkesa ligjore dhe nuk ekziston asnjë shkelje procedurale që do ta bënte vendimin të paligjshëm. Pretendimet e ankuesit lidhur me ligjshmërinë e vendimit për transferim janë objekt i një procedure tjetër administrative dhe nuk përbëjnë çështje që ndikon në vlefshmërinë e procedurës disiplinore, përderisa vendimi për transferim ka qenë në fuqi dhe i ekzekutueshëm në kohën e ndodhjes së shkeljes disiplinore. Ligjshmëria eventuale e transferimit nuk e justifikon moszbatimin e një vendimi administrativ në fuqi.

Gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike administrative, Kolegji i Këshillit, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit, dhe sipas shkresave të lëndës, rezulton se sipas Vendimit me Nr. 2388/2025 të datës 31.12.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, është transferuar në pozitën *Asistent Administrativ* në Qendrën për Regjistrimin e Automjeteve në Skenderaj, Drejtorati për Regjistrimin e Automjeteve, Agjencia e Regjistrimit Civil/MPB, mirëpo ankuesi bazuar edhe në këshillën juridike të këtij vendimi, përmes ankesës së dorëzuar më postë më datë 30.01.2026 pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e ka kontestuar këtë vendim për shkak të pretendimeve për paligjshmërinë e tij.

Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se organi përkatës i punësimit gjegjësisht Ministria e Punëve të Brendshme, në mënyrë të kundërligjshme ka zbatuar Vendimin me Nr. 2388/2025 të datës 31.12.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, sepse meqë ndaj vendimit pala ka pasur të drejtë ankesë atëherë i njëjti nuk ka mundur të bëhet i ekzekutueshëm pa u plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara me dispozitat e nenit 144 paragraf 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet: *“1.Një akt administrativ do të bëhet i ekzekutueshëm me: 1.1. skadimin e afatit për ankesën kundër tij, nëse një ankesë e tillë nuk është parashtruar; 1.2. njoftimin e palës, me aktin, kur sipas ligjit, nuk lejohet ankesa; 1.3. njoftimin e palës me aktin, kur, sipas ligjit, ankesa nuk ka efekt pezullues 1.4. njoftimin e palës me aktin e ndalimit të efektit pezullues të ankesës, në pajtim me paragrafin 3 të nenit 130 të këtij Ligji, apo 1.5. njoftimin e palës për refuzimin e ankesës”,* pra Ministria e Punëve të Brendshme përmes përgjigjes në ankesë të datës 10.04.2026, ka qenë e njoftuar që duhet të pezullohen të gjitha efektet e zbatimit të vendimit të kontestuar meqë ndaj tij është parashtruar ankesë, e për rrjedhojë duke qenë se ndaj Vendimit me Nr. 2388/2025 të datës 31.12.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ishte parashtruar ankesë, organi publik ka qenë i obliguar që të pezullojë çdo veprim që ndërlidhet me këtë vendim, ngase kjo është përcaktuar sipas nenit 130 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet: *“1. Përveçse kur parashkohet ndryshe me ligj, parashtrimi i një ankesë pezullon, sipas fuqisë së ligjit, prodhimin e pasojave juridike të aktit administrativ, deri në njoftimin e vendimit që zgjidh ankesën”.*

Kolegji i Këshillit, bazuar në at që u tha si më lartë konstaton se të gjitha pretendimet e organit publik/Ministrisë së Punëve të Brendshme në raport me iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit kanë qenë që i njëjti nuk është paraqitur në vendin e punës të transferuar sipas Vendimit me Nr. 2388/2025 të datës 31.12.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, e mbi këtë konstatim edhe Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme ka nxjerr Vendimin me Nr. 261/2026, i datës 04.02.2026, duke i shqiptuar masën disiplinore *Largim nga Shërbimi Civil*, andaj në aspektin e shqyrtimit të ligjshmërisë së këtij vendimi, Kolegji i Këshillit, vë në dukje, se ndaj ankuesit në rastin konkret nuk është dashur të merret asnjë masë në raport me Vendimin me Nr. 2388/2025 të datës 31.12.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, sepse nuk ka pasur asnjë vendim përfundimtar lidhur me ligjshmërinë e këtij vendimi dhe i njëjti ligjërisht nuk ka mundur të ekzekutohet përderisa ndaj tij është ushtruar ankesë.

Përkitazi me këtë, Kolegji i Këshillit, vlerëson se veprimet e ndërmarra ndaj ankuesit për iniciim të procedurës disiplinore për mos bindje ndaj një akti administrativ ku ankuesi ka parashtruar ankesë, janë veprime të kundërligjshme dhe për rrjedhojë janë veprimet paragjyquese në raport me vendimarrjen ndaj ankesës së palës, kështu që në këtë rast Vendimi me Nr. 261/2026, i datës 04.02.2026, i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, cenon parimin e sigurisë juridike në raport me palën ankuese dhe si i tillë përveç që është në kundërshtim me parimet e përcaktuara me nenin 8 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet: *“Menaxhimi i marrëdhënies së punës së nëpunëses/it civil, nëpunëses/it të shërbimit publik, krijueses/it dhe performueses/it të artit dhe kulturës, si dhe nëpunëses/it teknike dhe mbështetëse, bazohet në parimin e ligjshmërisë, integritetit, meritës, transparencës, profesionalizmit, paanësisë partiake dhe mosdiskriminimit”,* vendimi i kontestuar është në kundërshtim me parimet e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe si i tillë është i paligjshëm në kuptim të nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.5, 1.6 dhe 1.7 të Ligjit Nr.

05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që bazuar në konstatimet si më sipër pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuara, ndërsa bazuar në dispozitivin e këtij vendimi dhe të mbështetur në arsyetimin e të njëjtit vendim, duke qenë se organi që ka marr vendimin ndaj palës është Ministria e Punëve të Brendshme konkretisht Komisioni Disiplinor, atëherë në këtë kuptim Sekretari i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, duhet të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme administrative për kthimin e ankuesit në pozitën e punës sipas akt emërimit me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës dhe kompensimin e pagave nga dita e largimit nga shërbimi civil deri në zbatimin e këtij vendimi, duke hequr edhe masën disiplinore nga dosja personale e ankuesit. Ndërsa lidhur me çështjen e transferimit të përkohshëm të ankuesit Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, do të vendos me vendim të veçantë, për shkak që paraprakisht këtë çështje e kishte pezulluar sipas Vendimit A.nr.114/2026, të datës 23.03.2026.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë Juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda;A.nr.282/2026,datë 20/05/2026

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit


Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit I.GJ;
- Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Digjitalizimit dhe Administratës Publikë si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



A.br.282/2026

Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova – Veće za razmatranje i rešavanje žalbi u sastavu: Arben Mehmeti-predsednik, Malsore Gashi-Bajraktari i Eshref Shabani-članovi, i Avdyl Bekteshi u svojstvu zapisničara, u postupku po žalbi broj A.br.282/2026, od 12.03.2026.godine, koju je uložio podnosilac žalbe Ivan Đorđević iz Zvečana, protiv organa zapošljavanja:Ministarstva unutrašnjih poslova, po pravnoj stvari "*disciplinska mera*", u skladu sa članom 6. stav 1. podstav 1.1, članom 16. stav 3 i članom 18. stav 1 podstav 1.2 Zakona br.06/L-048 o Nezavisnom nadzornom odboru civilne službe Kosova, kao i na osnovu odredbi Pravilnika br.02/2028 o Proceduri razmatranja i rešavanja žalbi u Nezavisnom nadzornom odboru civilne službe Kosova, dana 20.05.2026.godine, donosi ovu:

ODLUKU

I. Usvaja se kao osnovana žalba broj A.br.282/2026, od 12.03.2026.godine, koju je uložio podnosilac žalbe Ivan Đorđević.

II. Poništava se Odluka br.261/2026 od 04.02.2026.godine, doneta od disciplinske komisije Ministarstva unutrašnjih poslova.

III. Obavezuje se generalni sekretar i kadrovski rukovodilac u Ministarstvu unutrašnjih poslova, da izvrše sprovođenje ove odluke u roku od 15 dana od dana primanja, preduzimanjem svih neophodnih upravnih radnji, radi vraćanja podnosioca žalbe na njegovo radno mesto, u skladu sa aktom o imenovanju sa svim pravima i obavezama iz radnog odnosa i naknadu plata od danja otpuštanja iz civilne službe do sprovođenja ove odluke, uklanjajući i disciplinsku meru iz ličnog dosijea podnosioca žalbe.

IV. Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova, treba biti pismeno obavestiti o preduzetim radnjama.

O b r a z l o ž e n j e

Podnosilac žalbe Ivan Đorđević (*u daljem tekstu: žalioac*), dana 09.03.2026.godine putem pošte uložio je žalbu Nezavisnom nadzornom odboru civilne službe Kosova, koja je primljena dana 12.03.2026.godine, registrovana pod oznakom A.br.282/2026, protiv Odluke br.261/2026 od 04.02.2026.godine, doneta od disciplinske komisije Ministarstva unutrašnjih poslova.

Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova (*u daljem tekstu samo Odbor*), na osnovu odredbi Uredbe br.02/2018 o Proceduri razmatranja i rešavanja žalbi, dana 18.03.2026.godine, procesuirao je zahtev radi odgovora na žalbu, upućen Ministarstvu unutrašnjih poslova, pa je Ministarstvo unutrašnjih poslova, 10.04.2026.godine, dostavilo odgovor na žalbu zajedno sa priloženim spisima predmeta u vezi odgovarajućeg žalbenog predmeta.

Predsednik Odbora, dana 22.04.2026.godine, doneo je Odluku pod oznakom VK/2026 i brojem protokola:2056/2026, kojom je rok za odlučivanje o žalbi podnosioca žalbe, pod oznakom A.br.282/2026 od 12.03.2026.godine produžen za još deset (10) radnih dana.

Veće za razmatranje i rešavanje žalbi (u daljem tekstu: Veće Odbora) za meritorno odlučivanje utvrdilo je sledeće dokaze: Žalbu broj protokola 1282/2026, od 12.03.2026. godine, koju je podnosilac žalbe podneo Nezavisnom nadzornom odboru civilne službe Kosova; Obrazac za podnošenje žalbe od 12.03.2026.godine; Zahtev za odgovor na žalbu od 18.03.2026.godine; Odluku broj 261/2026, od 04.02.2026.godine.; Odgovor na žalbu od 10.04.2026.godine, sa svim priloženim dokumentima od strane organa zapošljavanja; Akt o imenovanju podnosioca žalbe I.GJ od 29.12.2015.godine; Odluku o privremenom premeštaju civilnog službenika broj 2388/2025, od 31.12.2025.godine; Opis radnih zadataka; Diplomu broj 103/11, od 27.07.2011.godine; Akt o imenovanju G.E. broj protokola 570/1, od 15.07.2020.godine; Odluku o formiranju komisije, broj protokola 104/1, od 19.01.2026.godine; Diplomu broj 552, od 26.12.2011.godine; Akt o imenovanju B.K. od 22.08.2013.godine; Potvrdu od 13.01.2022.godine; Izmenu akta o imenovanju D.G. broj protokola br.369/1, od 26.05.2014.godine; E-mail od 26.01.2026.godine; Akt o imenovanju D.L. od 14.05.2013.; Odluku VK/2026 predsednika Odbora od 22.04.2026.godine.

Veće Odbora, nakon razmatranja i analiziranja priloženih spisa predmeta koje su stranke u postupku dostavile, zaključilo je da je žalba podnosioca žalbe osnovana, *jer:*

Iz utvrđenih predmetnih spisa, Veće Odbora utvrdilo da je podnosilac žalbe, shodno Aktu o imenovanju od 29.12.2015.godine, zaposlen na radnom mestu "*Tehnički administrator za kontrolu održavanja*" u Odeljenju za standarde inženjerskih politika i Upravljanje vladinim zgradama u Ministarstvu unutrašnjih poslova, ali je isti, prema Odluci br.2388/2025 od 31.12.2025.godine, doneta od generalnog sekretara Ministarstva unutrašnjih poslova, premešten na radno mesto Administrativnog asistenta u Centru za registraciju vozila u Skenderaju, Direkcija za registraciju vozila, Agencija za civilnu registraciju/MUP.

Zbog nepojavljivanja na radnom mestu na koje je premešten, na osnovu Odluke br.2388/2025 od 31.12.2025.godine, protiv podnosioca žalbe dana 23.01.2026.godine pokrenut disciplinski postupak pred disciplinskom komisijom Ministarstva unutrašnjih poslova zbog teških disciplinskih kršenja, dalje, disciplinska komisija Ministarstva unutrašnjih poslova je dana 04.02.2026.godine donela Odluku br.261/2026, kojom je podnosilac žalbe proglašen odgovornim za teške disciplinske prekršaje, propisane članom 56. stav 4. podstav 4.1, 4.4 i 4.10 Zakona br.08/L-197 o Javnim službenicima, izrekavši mu disciplinsku meru *Otpuštanje iz civilne službe*.

Podnosilac žalbe, u žalbi podnesenoj u Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova, protiv Odluke br.261/2026 od 04.02.2026.godine, doneta od disciplinske komisije Ministarstva unutrašnjih poslova, tvrdi da podnošenje žalbe u Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova, obustavlja dejstvo sprovođenja odluke o premeštaju, odnosno Odluke br.2388/2025 od 31.12.2025.godine, žalioc takođe tvrdi da osporena odluka nema obrazloženje i da je u suprotnosti sa članom 48. Zakona br.05/L-031 o Opštem upravnom postupku i materijalnim pravom, kao što isti osporava i sastav komisije.

Ministarstvo unutrašnjih poslova, putem svog odgovora u žalbi od 10.04.2026.godine, osporava žalbene tvrdnje podnosioca žalbe, naglašavajući da odluka o premeštaju nije poništena, ukinuta niti je obustavljena od strane nadležnog organa, te da se shodno tome, radilo o važećem i izvršnom upravnom aktu, koji je proizveo pravne posledice i bio je obavezujući za sprovođenje, te je stoga žalioc bio dužan da se javlja na novo radno mesto do donošenja konačne odluke. Disciplinska komisija formirana je i funkcioniše u potpunosti u skladu sa članom 10. stav 2 Uredbe (VRK) br.01/2024, prema kojem se komisija sastoji od tri (3) člana, uključujući jednog predstavnika Jedinice za upravljanje ljudskim resursima i najmanje jednog pravnika. Sastav komisije bio je u skladu sa ovim zakonskim zahtevima i ne postoji proceduralna povreda koja bi odluku učinila nezakonitom. Žalbene tvrdnje žalioca u vezi sa zakonitošću odluke o premeštaju, predmet su drugog upravnog postupka i ne predstavljaju pitanje koje utiče na valjanost disciplinskog postupka, budući da je odluka o premeštaju bila na snazi i izvršna u vreme disciplinskog kršenja. Moguća zakonitost premeštaja ne opravdava nesprovođenje jedne važeće upravne odluke.

Tokom razmatranja ove upravno-pravne stvari, Veće Odbora razmotrilo je žalbene tvrdnje podnosioca žalbe, i prema spisima predmeta, proizilazi da je shodno Odluci br.2388/2025 od 31.12.2025.godine, doneta od generalnog sekretara Ministarstva unutrašnjih poslova, premešten na radno mesto *Administrativni asistent* u Centru za registraciju vozila u Skenderaju, Direkcija za registraciju vozila, Agencija za civilnu registraciju/MUP, međutim, podnosilac žalbe, i na osnovu pravne pouke u ovoj odluci, putem žalbe dostavljene poštom dana 30.01.2026.godine u Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova, osporio je ovu odluku zbog tvrdnji o njenoj nezakonitosti.

Shodno tome, Veće Odbora zaključuje da je nadležni organ zapošljavanja, odnosno Ministarstvo unutrašnjih poslova, nezakonito sprovelo Odluku br.2388/2025 od 31.12.2025.godine, donetu od generalnog sekretara Ministarstva unutrašnjih poslova, jer, budući da je stranka imala pravo žalbe na odluku, ista nije mogla postati izvršna bez ispunjavanja zakonskih uslova utvrđenih odredbama člana 144. stav 1 Zakona br.05/L-031 o Opštem upravnom postupku, koji propisuje: „*Administrativni akt postaje izvršni po: 1.1. isteku roka za žalbu protiv istog, ako takva žalba nije podneta; 1.2. obaveštavanju stranke o aktu, kada zakonski nije dozvoljena žalba; 1.3. obaveštavanju stranke o aktu,*

kada zakonski žalba nema suspenzivno dejstvo; 1.4. obaveštavanju stranke o aktu za ukidanje suspenzivnog dejstva žalbe, u skladu sa stavom 3. člana 130 ovog zakona; ili 1.5. obaveštavanju stranke o odbijanju žalbe, dakle Ministarstvo unutrašnjih poslova je putem odgovora na žalbu od 10.04.2026.godine, bilo obavešteno da se svi efekti izvršenja osporene odluke trebaju obustaviti, jer je protiv nje podnesena žalba, te shodno tome, budući da je na Odluku br.2388/2025 od 31.12.2025.godine, doneta od generalnog sekretara Ministarstva unutrašnjih poslova podnesena žalba, javni organ je bio dužan da obustavi svaku radnju u vezi s ovom odlukom, jer je to određeno članom 130. stavom 1 Zakona br.05/L-031 o Opštem upravnom postupku, koji propisuje: "1. Osim ako zakonom nije drugačije određeno, podnošenje žalbe obustavlja, po sili zakona, nastanak pravnih posledica upravnog akta, do obaveštavanja o odluci kojom se rešava žalba".

Veće Odbora, na osnovu gorenavedenog, zaključuje da su sve tvrdnje javnog organa/Ministarstva unutrašnjih poslova u vezi s pokretanjem disciplinskog postupka protiv podnosioca žalbe, bili da se isti nije pojavio na premeštenom radnom mestu, shodno Odluci br.2388/2025 od 31.12.2025.godine, doneta od generalnog sekretara Ministarstva unutrašnjih poslova, te je na osnovu ovog nalaza i disciplinska komisija Ministarstva unutrašnjih poslova donela Odluku br.261/2026 od 04.02.2026. godine, izričući disciplinsku meru *Otpuštanje iz civilne službe*, te stoga, u smislu preispitivanja zakonitosti ove odluke, Veće Odbora, napominje da u konkretnom slučaju protiv podnosioca žalbe nije trebala biti preduzeta nikakva mera u vezi s Odlukom br.2388/2025 od 31.12.2025.godine, doneta od generalnog sekretara Ministarstva unutrašnjih poslova, jer nije bilo niti jedne konačne odluke u vezi s zakonitošću ove odluke i ista se nije mogla zakonito izvršiti, sve dok je protiv nje podnesena žalba.

U tom smislu, Veće Odbora ocenjuje da radnje preduzete protiv podnosioca žalbe radi pokretanja disciplinskog postupka zbog nepoštovanja jednog upravnog akta, gde je podnosilac žalbe podneo žalbu, predstavljaju nezakonite radnje i posledično su pristrasne radnje u odnosu na odlučivanje o žalbi stranke, tako da u ovom slučaju Odluka br.261/2026, od 04.02.2026.godine, doneta od disciplinske komisije Ministarstva unutrašnjih poslova, krši princip pravne sigurnosti u odnosu na podnosioca žalbe i kao takva, pored toga što je u suprotnosti sa principima utvrđenim u članu 8. stav 1 Zakona br. 08/L-197 o Javnim službenicima, koji propisuje: „*Upravljanje radnim odnosom civilnih službenika/ice, zaposlenika u javnim službama, stvaralaca i izvođača umetnosti i kulture, kao i tehničkih i pomoćnih radnika, zasniva se na principu zakonitosti, integriteta, zasluga, transparentnosti, profesionalnosti, nepristrasnosti stranke i nediskriminacije*“, osporena odluka je u suprotnosti i sa principima Zakona br.05/L-031 o Opštem upravnom postupku i kao takva je nezakonita u smislu člana 52. stav 1 podstav 1.3, 1.5, 1.6 i 1.7 Zakona br.05/L-031 o Opštem upravnom postupku, pa na osnovu gorenavedenih konstatacija, žalbene tvrdnje žalioaca su osnovane, dok na osnovu dispozitiva ove odluke i na osnovu obrazloženja iste odluke, s obzirom na to da je organ koji je doneo odluku protiv stranke Ministarstvo unutrašnjih poslova, konkretnije disciplinska komisija, te u tom smislu, generalni sekretar i kadrovski rukovodilac u Ministarstvu unutrašnjih poslova, trebaju preduzeti sve potrebne upravne radnje, kako bi se žalioac vratio na radno mesto, shodno Aktu o imenovanju, sa svim pravima i obavezama iz radnog odnosa i naknadom plate od dana otpuštanja iz civilne službe do izvršenja ove odluke, uz istovremeno brisanje disciplinske mere iz ličnog dosijea podnosioca žalbe. Međutim, u vezi pitanja privremenog premeštaja podnosioca žalbe, Nezavisni nadzorni odbor civilne službe Kosova odluči će posebnom odlukom, jer je prethodno obustavio ovo pitanje, na osnovu Odluke A.br.114/2026 od dana 23.03.2026.godine.

Stoga je, nakon analiziranja i ocene predmetnih spisa i na osnovu člana 6. stav 1 podstav 1.1, člana 18. stav 1. podstav 1.2 Zakona br.06/L-048 o Nezavisnom nadzornom odboru civilne službe Kosova, Veće Odbora odlučilo kao u dispozitivu ove odluke.

Odluka stupa na snagu danom potpisivanja od strane predsednika Veća.

Pravna pouka: Protiv odluke Odbora, nezadovoljna stranka može pokrenuti upravni spor u Upravni sud u Prištini-Odeljenje za Radne sporove, u roku od trideset (30) dana od dana kada joj je predata odluka. Pokretanje upravnog spora ne zadržava izvršenje ove odluke.

NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
Predmet A.br.282/2026 od 20.05.2026.god.

Avdyl BEKTESHI

Zapisničar

Arben MEHMETI

Predsednik Veća

Odluku dostaviti:

- Podnosiocu žalbe Ivanu Đorđeviću;
- Generalnom sekretaru i rukovodiocu Jedinice za upravljanje ljudskim resursima u Ministarstvu unutrašnjih poslova;
- Generalnom sekretaru i rukovodiocu Jedinice za upravljanje ljudskim resursima u Ministarstvu digitalizacije i Javne uprave, kao i
- Arhivi NNOCSK-a.

Preveo:

Sh.Mujko

Sh. Mujko

Dana, 20.05.2026.god.